



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 475/8 Prot.

Tiranë, më 11.03.2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 35, datë 11.03.2026

PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE SPECIALIZIME AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2025-2026

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78; të Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; të Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, miratuar me Vendim nr. 28, datë 25.02.2026 të Senatit Akademik; të Vendimit nr. 154, datë 19.12.2025 "Për miratimin e kuotave të pranimit, tarifave të konkurrimit dhe të shkollimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", i ndryshuar me Vendim Qarkullues nr. 18, datë 19.02.2026 të Senatit Akademik, si dhe propozimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me shkresën nr. 393/3 prot., datë 12.02.2026; të Ministrisë së Punëve të Brendshme me shkresën nr. 814/1 prot., datë 23.02.2026; të Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën nr. 2130/1 prot., datë 27.02.2026 dhe të Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 1130/1 prot., datë 03.03.2026, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2025-2026, janë 304 (treqind e katër) të ndara si më poshtë:

a) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	148
b) Kuota pranimi nga Ministria e Punëve të Brendshme	10
c) Kuota pranimi nga Ministria e Mbrojtjes	9
d) Kuota pranimi nga Ministria e Drejtësisë	15
e) Kuota të lira (të pa mbuluara)	117
f) Kuota për transferim të studimeve nga IAL të tjera	5

2. Kuotat e pranimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën 1/a), b), c), d) dhe e) të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (5 kuota) shpërndahen nga Rektori i UMT-së, bazuar në propozimet e dekanateve, sipas kërkesave të aplikantëve që vijnë nga institucione të tjera të arsimit të lartë, në programe specializuese afatgjata të njëjta apo të të njëjtit profil. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.
4. Aplikojnë në programe studimi specializuese afatgjata, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e mjekësisë, në udhëzimin përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
5. Pranimet e studentëve në programet specializuese afatgjata sipas kuotave të miratuara në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në udhëzimin përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
6. Dokumentacioni i dorëzuar nga kandidati, i nënshtrohet konfirmimit të vërtetësisë me institucionet që e kanë lëshuar.
7. Tarifa e aplikimit dhe konkurrimit në programet specializuese afatgjatë apo tarifa e aplikimit për transferim studimesh është 5000 (pesëmijë) lekë. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi është 115,000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë (tarifa e konkurrimit/aplikimit dhe tarifa e shkollimit është e njëjtë me tarifën e vitit të mëparshëm akademik). Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa kështu e tjera arkëtohen sipas afateve dhe masës në përqindje të përcaktuara nga fakultetet përkatëse.
8. Studenti, i cilësuar përsëritës, në bazë të rregullores së UMT-së, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
9. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas pikës 1/b), c) dhe d) të këtij vendimi duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse. Studentët e shpallur fitues në kuotat sipas pikës 1/a), b), c) dhe d) të këtij vendimi lidhin kontratë me ministrinë përkatëse.
10. Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj, detyrimet, penalitetet në rast mosrespektimi të tyre, është përgjegjësi e ministrive përkatëse, të cilat kanë dhe detyrimin e njoftimit të kandidatit lidhur me këtë aspekt, para hapjes së procesit të aplikimeve.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i njërive kryesore përkatëse të UMT-së, pa efekte buxhetore shtesë.
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe i përcillet për zbatim Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe Ministrive përkatëse, si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore për vijimin e mëtejshëm të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata të ciklit tretë në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

KRYETARI

Prof. Dr. Xheladin DRACINI



TABELA NR. 1: Shpërndarja e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, në UMT, për vitin akademik 2025-2026

Nr.	NJËSIA KRYESORE	PROGRAMI I STUDIMIT	KUOTA TË MIRATUARA PËR V.A. 2025-2026	KUOTA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MS	KUOTA MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	KUOTA MINISTRIA E MBROJTJES	KUOTA MINISTRIA E DREJTËSISË	KUOTA TË LIRA
1	F. Mjekësisë	Alergologji dhe Imunologji Klinike	5					5
2	F. Mjekësisë	Anatomi Patologjike	5					5
3	F. Mjekësisë	Anestezi-Reanimacion	20	20				0
4	F. Mjekësisë	Diagnozë me Imazhe	10	7	1	1	1	0
5	F. Mjekësisë	Dermatologji dhe Venerologji	5			3	2	0
6	F. Mjekësisë	Endokrinologji	5		2	3		0
7	F. Mjekësisë	Gastrohepatologji	5					5
8	F. Mjekësisë	Hematologji	5	5				0
9	F. Mjekësisë	Kardiokirurgji	5					5
10	F. Mjekësisë	Kardiologji	12	2	1		2	7
11	F. Mjekësisë	Kirurgji e Përgjithshme	20	15				5
12	F. Mjekësisë	Kirurgji Plastike, Rikonstruktive dhe Estetike	5		3			2
13	F. Mjekësisë	Laborator Klimik-Biokimik	5	5				0
14	F. Mjekësisë	Mikrobiologji	5	5				0
15	F. Mjekësisë	Mjekësi Familje	20	15				5
16	F. Mjekësisë	Mjekësi Interne	10	3				7
17	F. Mjekësisë	Mjekësi Lgjore	5			1		0
18	F. Mjekësisë	Mjekësi Urgjence	12	12			5	0
19	F. Mjekësisë	Mjekësi Transfuzive	5	3				2
20	F. Mjekësisë	Nefrologji	7	5				2
21	F. Mjekësisë	Neurologji	5	3			1	0
22	F. Mjekësisë	Neurokirurgji	5					5
23	F. Mjekësisë	Otorinolaringologji	5	5				0
24	F. Mjekësisë	Obstetrikë-Gjinekologji	8	8				0
25	F. Mjekësisë	Okulistikë	5	5				0
26	F. Mjekësisë	Onkologji	8	8				0
27	F. Mjekësisë	Ortopedi-Traumatologji	5					5
28	F. Mjekësisë	Pediatri	20	20				0
29	F. Mjekësisë	Pneumologji	7				1	6
30	F. Mjekësisë	Psikiatri	10				2	8
31	F. Mjekësisë	Psikiatri e Fëmijëve dhe Adoloshentëve	5					5
32	F. Mjekësisë	Reumatologji	5					5
33	F. Mjekësisë	Sëmundje Infektive	10					10
34	F. Mjekësisë	Shëndet Publik	5					5
35	F. Mjekësisë	Toksikologji Klinike	5	2				3
36	F. Mjekësisë Dentare	Kirurgji Maksilo-Faciale	5		3	1		0
37	F. Mjekësisë Dentare	Ortodonci	5					5
38	F. Mjekësisë Dentare	Pedodonti	5					5
39	F. Mjekësisë Dentare	Terapi Stomatologjike	5					5

*5 kuota për transferim studimesh në Fakultetin e Mjekësisë, UMT, nga IAL të tjera.